

Deri në Fund të 2006-tës: Çfarëdo Vonimi, Humbja sa më e Madhe

**Shkruan:
Halit Bislimi**

**Gjilan, Kosovë
25 Tetor 2006**

Ishte një rrugë e gjatë dhe e mundimshme e Kosovës për clirim kombëtar, që nga viti 1912 e deri në vitin 1999. Në vitet 1998/99 ndodhi lufta në Kosovë, e cila edhe pse shumë e dhimbshme, megjithatë, ndau rrugëtimit e Kosovës dhe të Serbisë, mjëherë e përgjithmonë. Por, këto dy vende janë dhe të jenë praën njëra tjetërs. Andaj iu duhet ndërtimi i fqinjësisë së mirë, duke mos shikuar prapa për të ecur përpara. Ajo që po e bënë Kosova i jep shansin e mirë këtyre marrëdhënjev, ndërsa ajo cfarë po bënë Sebia e jep shansin më të keq të mundshëm për ndërtimin e këtyre marrëdhënjev.

Kosova, pjesë integrale e Serbisë në kushtetutën e Serbisë, është shansi më i keq për krijimin e marrëdhënjev fqinjësore të Kosovës me Serbinë.

Kosova e ka të vështirë (cilatdo forca që ta qeverisinë Kosovën), të ndërtojë marrëdhënje të mira fqinjësore me një shtet tjetër, i cili në preambulën e kushtetutës së vet, haptas paraqet pretendimet territoriale ndaj Kosovës.

Kosova ka vullnetin e mirë për fqinjësi të mirë (përkundër asaj cfarë i ka ndodhë në të kaluarën e largët dhe të afërtë), por fqinji i saj verior nuk e ka dhe nuk do të ketë një vullnet të tillë edhe për sa kohë.

Forcat politike “demokratike” të Serbisë, të cilat po kërkojnë shtyrjen e procesit për përfundimin e zgjidhjes së statusit përfundimtar të Kosovës, janë pot ë njejtat forca, të cilat pretendimin territorial ndaj Kosovës e paraqesin me futjen në preambulë të kushtetutës së tyre si territory të vetin, dhe ate duke shfrytëzuar status quon në Kosovë, andaj cila do të ishte arsyeja për të pritur zgjedhjet e reja në Serbi, kur dihet se nëse fitojnë forcat demokratike në Serbi, Kosova do të jetë e proklamuar si territor i Serbisë, njashtu sikurse pot ë fitonin forcat radikale të Serbisë.

Ne duhet të jemi koshient, se Kosova është vonuar më së paku për dy vite, ashtu sic janë vonuar Qendrat e Vendosjes Politike ndërkombëtare për së paku dy vite për të zgjidhur statusin final të Kosovës, ashtu sic është menduar me vendosjen e protektoratit ndërkombëtar në Kosovë, e cila sipas opinionit të përgjithshëm kosovarë është dashur që brenda tri deri në pesë vite, bashkë me faktorin vendor, të ndërtojë institucionet e përkohëshme vetëqeverisëse në Kosovë si dhe infrastrukturën tjetër ligjore, dhe për të përmbyllë ate në pajtim me vullnetin e shumicës në Kosovë, dhe në pajtim me parimet demokratike sipas standardeve Euro-Atlantike.

Pasojat e zvarritjes së procesit parastatutar do të ishin shumë më të mëdha për Kosovën dhe tërë Ballkanin, se sa pasojat nga përmbyllja e këtyre proceseve, sikurse benifitet që do të ishin shumë më të mëdha për Kosovën në radhë të parë, por edhe për Ballkanin në tërësi, me zgjidhjen e statusit në afatin sa më të shkurtër, pra ashtu sic është paraparë nga KS i OKB-së që ato të përfundojnë brenda mandatit të kryenegociatorit z. Ahtisari, pra brenda këtij vitit 2006.

Bindja është e fortë se sikur ky proces të ishte përmbyllë deri më tani, edhe Serbisë do t’i ikte aduti për të bërë një kushtetutë të ngutshme, e cila do të jetë kundërproduktive dhe me pasoja të mëdha, në radhë të parë për Serbinë, por edhe për serbët e Kosovës, ku një pjesë e tyre do të vazhdojë të jetojë në iluzione për kthim të Serbisë në Kosovë.

Zgjidha e statusit të Kosovës, do të ishte shumë produktive edhe për serbët e Kosovës, sepse ata do të pushonin të jetonin me iluzione të kota dhe do të angazhoheshin më tepër në jetën civile dhe institucionale të Kosovës, për të realizuar të drejtat prej qytetari të barabartë dhe për të krijuar të ardhmen e tyre.

Z. Ahtisari dhe Grupi i Kontaktit, meqenëse janë më përgjegjës për këto procese, të tregojnë pjekurinë, unitetin dhe efektivitetin për të përmbyllë këtë periudhë mjegullie, dhe për t'iu dhënë mundësinë qytetarëve të Kosovës, pa dallime të asnjë structure, për të ndërtuar ardhmërinë e vet dhe fëmijëve të tyre, sikurse edhe qytetarët e vendeve tjera në botë.

Të gjithë jemi dëshmitarë se Kosova deri më tani nuk ka patur mundësinë e zhvillimit ekonomik, dhe popullësia e saj vetëm sa po mbijeton. Investimet e mëdha ende nuk po ndodhin, dhe ato nuk do të ndodhin për derisa Kosovës të mos i njihet ndërkombëtarisht pavarësia dhe sovraniteti.

Kam patur fatin e mirë që të jem present në Dëgjimin Kongresial në Komitetin për Marrëdhënje Ndërkombëtare të Kongresit Amerikan, më 18 Maj 2005 në Washington DC, e cila seancë ishte sponsoruar në Liga Qytetare Shqiptaro-Amerikane, nën leadershipin tani më të dëshmuar në ballë të kauzës kombëtare shqiptare të ish-kongresistit Joe DioGuardi dhe znj. Shirley Cloyes, dhe në atë seancë, përveç argumenteve tjera, se, pse duhet njohur pavarësia e Kosovës nga Qeveria Amerikane, ishte edhe argumenti i (mos) zhvillimit ekonomik, i cili sipas afaristëve potencial për të investuar në Kosovë, ajo nuk mund të ndodhë para aktit të njohjes së pavarësisë së Kosovës. Shumë nga këta afaristë, në pyetjet e kongresmenëve; se pse nuk po investojnë në Kosovë, pasonte përgjigja e njejtë: “Kosova tani për tani është pezull, pa status të kjarhtë, por pas njohjes së pavarësisë, ne do të investojmë shumë capital atje”. Pra, shikuar edhe nga ky aspekt, Kosovës nuk duhet rrezikuar më e ardhmja, sepse nga aspekti social, i cili dita ditës po vështirësohet dhe është në rritje e sipër, mund të jetë një bombë e kurdisur për Kosovën, nëse edhe më tutje vazhdohet status-quoja.

Shtyerja eventuale e definimit përfundimtar të statusit të Kosovës, që me shumë intensitet kundërshtohet nga lobi i vetëm shqiptar në SHBA - Liga Qytetare Shqiptaro-Amerikane, do të jetë një shans i mirë për radikalët, qofsh të Serbi, në Kosovë apo gjetiu në Ballkan. Radikalët në Serbi, atë shansë do ta shfrytëzonin për të krijuar trazira në Kosovë apo edhe do të shkponin në ekstremin tjetër, duke u bazuar edhe në kushtetutën e re të Serbisë që të tentojnë edhe për një luftë në Kosovë. Radikalët në Kosovë, do të kërkojnë bashkimin me Shqipërinë, apo edhe bashkimin e trojeve shqiptare. Lëvizjet në Maqedoni Mal të Zi e gjetia do të pasonin këto veprime. Radikalët në shtetet tjera për rreth poashtu do të kërkonin krijimin e shteteve nacionale në Ballkan. Kështu, i tërë Ballkani do të shkonte kah krijimi i shteteve nacionale, pra, lëvizje kufijsh shtetëror, cka do të thotë ndjellje e luftërave të reja, katastrofave humanitare me pasoja të parashikueshme.

Është koha e fundit, kur bota demokratike (faktori vendosës politik ndërkombëtar) duhet t'ia bëjë me dije Serbisë, se me vendosjen e Kosovës në preambulë të kushtetutës si territor Serbisë, para se të vendoset për statusin final të Kosovës, vetëm se do t'i largojë dhe vështirësojë ndërtimin e raporteve për krijimin e marrëdhënjeve të mira me Kosovën dhe faktorin ndërkombëtar e sidomod me Bashkësinë Europiane, ku pretendon Serbia të ketë vendin nesër.

Për t'iu ikur të gjitha këtyre mundësive ekstreme, statusi i Kosovës duhet të definohet sa më shpejtë, brënda vitit 2006, dhe të vendoset në favor të së drejtës, në favor të vullnetit shumicë në Kosovë, e ajo është pavarësia e Kosovës, si një garancë për paqë dhe stabilitet të qëndrueshëm në Ballkan.

**Autori është Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit The Bislimi Group dhe
Përfaqësues për Kosovë i Ligës Qytetare Shqiptaro-Amerikane.**

Ju lutem mos hezitoni që komentet tuaja në lidhje me këtë publikim t'i dërgoni përmes faqës sonë në internet (nën rubrikën "Komentet"). Komentet tuaja janë gjithëherë të mireseardhura.

The Bislimi Group

www.bislimi.org